

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Arrestime për pronat në Fier/ Dy ish-drejtorë të Kadastrës në pranga, ndërtuesi përfitoi 1143 ha
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kronika/arrestime-per-pronat-ne-fier-dy-ish-drejto-re-te-kadas-tres-ne-pranga-nder-i586671
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 11:47:34 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 12:00:09 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5b321bca598f4d774893f915a8d409d6afab515a02fa2266bdb6a3cca4268067
TEKSTI	09914bf1f9cc94dc12bf03d409e68c454f93316c8a5cd1b5081ddd7ab43c3dc1
PAMJA	e7bf81b76b26c060ca078a0156733ec1a0b2c32bf742020219df48bfe1b75421

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0c932ecc8f1f0a3e102b7f9d6f54bf8293896a9267ee9d99d7f698cd7b2c2ec0
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e203f033d074a2d3c42a790e4ddfadf0e6c8e1c0300d49c3347be227adaa7f43
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0c932ecc8f1f0a3e102b7f9d6f54bf8293896a9267ee9d99d7f698cd7b2c2ec0>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



1e [Vodhen me dhune xhiron ditore ne dy pika karburanti/ Shpallet ne kerkim 32-vjeçari, vijon puna per identifikimin e nje tjetri/ Jo ne emrin tone! / Studentet ne Prishtine fundit](#)

Arrestime për pronat në Fier/ Dy ish-drejtorë të Kadastrës në pranga, ndërtuesi përfitoi 1143 ha



17 Shtator 2026, 14:00Kronika TEMA



Katër persona janë arrestuar me kërkesë të Prokurorisë së Fierit, në kuadër të një hetimi për falsifikim dokumentesh, shpërdorim detyre dhe pastrim parash.

Bëhet fjalë për dy ish-drejtorë të Kadastrës së Fierit, Bardh Kapaj dhe Ertis Shehu, juristi Piro Çela dhe biznesmeni Kastriot Hasko, në kuadër të një hetimi për një skemë të dyshuar tjetërsimi pronash.

Në kuadër të hetimeve të nisura prej vitit 2025, është sekuestruar toka e dyshuar e tjetërsuar me një sipërfaqe totale 1143 ha si edhe 150 mijë euro.

Sipas Prokurorisë, biznesmeni Kastriot Haskaj ka përdorur dy vendime të falsifikuara të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në Fier, përmes të cilave ka arritur të regjistrojë në emrin e tij dhe të katër personave të tjerë 1143 hektarë tokë në zonat e Semanit të Ri dhe Sheq Marinasit.

Pasi ka regjistruar pronat, Haskaj dyshohet se ka përdorur edhe një prokurë të posaçme të falsifikuar, duke u paraqitur si përfaqësues i bashkëpronarëve të tjerë. Në këtë mënyrë, ai ua ka shitur tokat dy kompanive të ndryshme.

Në këtë skemë, sipas hetimeve, kanë pasur rol edhe zyrtarët e Kadastrës së Fierit.

Ish-drejtorët Ertis Shehu dhe Bardh Kapaj, së bashku me juristin Piro Çela, akuzohen se kanë regjistruar pronat në kundërshtim me ligjin, pa kërkuar konfirmimin e vendimeve të kthimit të pronave nga Agjencia e Trajtimit të Pronave.

Hetimet kanë zbuluar se ish-drejtori Bardh Kapaj, gjatë regjistrimit të njërës prej pasurive, ka tejkaluar edhe sipërfaqen e përcaktuar në vendimin e falsifikuar, duke bërë që biznesmeni të përfitonte një sipërfaqe tjetër të konsiderueshme toke.

Ndërkohë, ish-drejtori Ertis Shehu dhe juristi Piro Çela dyshohet se kanë ndryshuar në dokumente kategorinë e tokave nga tokë arë në tokë pa frut.

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Vodhën me dhunë xhiron ditore në dy pika karburanti/ Shpallet në kërkim 32-vjeçari, vijon puna për identifikimin e një tjetri

"S'ka celular, merrni laptop"/ GJKKO nuk tërhiqet nga rregullorja censuruese, i përgjigjet avokatëve: Zbatoheni, ose ndiqni rrugët ligjore!

12:30 Kronika / 1 koment

Sekuestrohen dy celularë të paligjshëm në burgje, procedohen 8 persona

11:30 Kronika

“Nuk më janë vënë në dispozicion të gjitha fashikuit” - Shtvhet divai i themelit për Ilir Metën, ia kur do të mbahet

seanca e radhës

11:00 Kronika

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.